

REPUBLIKA E KOSOVES · REPUBLIKA KOSOVA · REPUBLIC OF KOSOVO   ACTION FOR MOTHERS AND CHILDREN dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës Komiteti i punës së bashkëpunimit dhe bashkëpunimit të institucioneve shëndetësore të Kosovës Committee of work, midwives and other health professionals of Kosovo		
ARKIV ARHIV ARCHIVE		
Nr. Prot. 237 Broj. prot. 237 Prot. no	Nr. i Br. 1 Br. 1 No page 1	Data: 08.04.2019 Date: 08.04.2019
PRISTINE · PRISTINA · PRISTINA		



MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

E lidhur me datën 08.04.2019 në Prishtinë, në mes të:

1. OJQ “Aksioni për Nëna dhe Fëmijë (Numri i regjistrimit 5200275, me seli në Prishtinë, rruga Fazli Grajqevci, nr. 271, përfaqësuar nga Drejtoresha Mrika Aliu [tutje si “AMC”], dhe
2. Oda e Infermierëve të Kosovës, me seli në Prishtinë, rruga Holger Pedersen, 1000 Prishtinë, Kosovë, përfaqësuar nga Drejtori Naser Rustemaj [tutje si : OIK].

Tutje, bashkërisht referuar si Palët Bashkëpunuese.

Neni 1 - Qëllimi

Ky Memorandum Bashkëpunimi [tutje si “Memorandum”] përcakton të drejtat dhe detyrimet e AMC dhe OIK në lidhje me zhvillimin dhe koordinimin e aktiviteteve për promovimin e shëndetit të grave dhe fëmijëve në territorin e Kosovës.

Neni 2 –Kohëzgjatja

- 2.1 Ky Memorandum hyn në fuqi me datën **XX 2019** dhe përfundon deri në përfundimin e aktiviteteve të përbashkëta, siç është dakorduar me këtë Memorandum.
- 2.2 Palët mund të shkëpusin këtë Memorandum në mënyrë të një anshme, duke paralajmëruar palën tjetër së paku 30 ditë më herët.

Neni 3 – Të drejtat dhe zotimet e OIK

- 3.1 OIK ka të drejtë të marrë pjesë në aktivitetet e organizuara nga AMC, me qëllim të
 - 1). Promovimit të shëndetit të gruas shtatzënë dhe fëmijëve;
 - 2). Ngritjes së njohurive të personelit shëndetësor të inkuadruar në kujdesin primar, sekondar dhe terciar;
 - 3). Avokim për përmirësimin e shërbimeve shëndetësore për gratë dhe fëmijët;
 - 4). Avokim për të drejtat dhe kushtet e punës së personelit shëndetësor referuar si” infermiere dhe mami.
- 3.2 OIK mund të marrë pjesë në aktivitetet e organizuara nga AMC në cilësinë e monitoruesit dhe anëtarit të komisionit akreditues të programit.



Neni 4 – Të drejtat dhe zotimet e AMC

AMC merr përsipër që të njoftoj dhe të ftojë OIK në çdo konferencë, seminar, trajnim apo event të ngjashëm që zhvillohet nga AMC me qëllim të promovimit të shëndetit për nënat dhe fëmijët dhe avokimit.

Neni 5 – Ndryshimet në Memorandum

Palët dakordohen që çfarë do ndryshimi në këtë Memorandum ta kryejnë përmes anekseve me shkrim.


Neni 6 – Njoftimet dhe komunikimi

Palët dakordohen se të gjitha njoftimet në lidhje me zhvillimin e aktiviteteve të kryhen përmes postës elektronike të stafit të tyre.

Neni 7 – Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Për çfarëdo mosmarrëveshje në lidhje me këtë Memorandum Bashkëpunimi, palët marrin përsipër që të i zgjedhin bashkërisht me mirëkuptim.

Për AMC:


/nënshkrimi/

01/04/19
/data/



Për OIK


/nënshkrimi/


/data/

08.04.2019